Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDROMORAVA Sh.a.
No. 732 Data 05.06.2025
GJILAN

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
"Hidromorava" SH.A
Regionalna Kompanija za Vodovod
"Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, KRU "Hidromorava" - SH.A., në Gjilan shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Për plotësimin e vendit të lirë të punës në KRU. "Hidromorava" - SH.A., në Gjilan, për pozitën:

- **Drejtor Teknik.**

- **Institucioni:** Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidromorava" - Sh.A.
- **Numri i kryesve**: 1 (një).
- **Vendi i punës (lokacioni):** Gjilan.
- **Titulli i mbikëqyrësit:** Kryeshefi Ekzekutiv.
- **Kohëzgjatja e kontratës së punës:** Me kohë të caktuar (me periudhë provuese prej 3 (tre) muaj).
- **Paga bazë:** 1152.00€ (bruto)

II. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta

II.I. Kushtet e përgjithshme:
- **Përgatitja profesionale/shkollore**: Diplomë universitare - fakulteti i inxhinierisë ndërtimore - drejtimi hidroteknikë.
- **Përvoja e punës:** 5 vite punë profesionale, me së paku tri /3/ vite përvojë pune në menaxhim në fushën përkatëse.

II.II. Kushtet e veçanta:
- Njohja e fushës së veprimtarisë hidroteknike;
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë nën hetime apo të ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e programeve aplikative WaterCad, GIS, AutoCad, SewerCad;
- Të sigurojë komunikim dhe bashkëpunim të mirë me palët e interesit gjatë zbatimit të projekteve infrastrukturore;

- Përvoja e komunikimit me donatorë të përfshirë në sektorin e ujit dhe përvoja e punës me kompani të huaja në zbatimin e projekteve në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotur është përparësi;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;

III. Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

- Organizon, përfaqëson dhe koordinon punën e Departamentit Teknik;
- Bënë angazhimin e gjithë potencialit të vet të ekspertëve, punëtorëve, mekanizmit dhe pajisjet teknike që posedon ose që do të plotësoj në mënyrë që të jetë efikas dhe të kryejë këtë punë në kohë sa më të shpejtë dhe me rezultate të kënaqshme;
- Bënë planin e punës, planin vjetor të remonteve, të mirëmbajtjes së objekteve në pikëpamje investive dhe të rregullt duke paraparë materialin e nevojshëm dhe pjesët e ndërrimit;
- Kryen mbikëqyrjen e punimeve të investimeve nga KRU "Hidromorava" Sh.A. dhe akterë të tjerë, që nuk janë përfunduar ende ose që do të kenë punë plotësuese deri në përfundimin e tyre të plotë investiv sipas mjeteve të lejuara deri më tani ose që do të lejohen në të ardhmen;
- Kujdeset për ruajtjen e dokumentacionit teknik për të gjitha objektet e hidrosistemit në arkivën e tij;
- Formon dokumentacionin e rregullt dhe kujdeset për ruajtjen tij;
- Është përgjegjës ndaj ligjeve shtetërore që rregullojnë veprimtarinë nga lëmitë e profileve të këtij shërbimi dhe kujdeset që ti marrë masat e duhura sidomos për mbrojtje higjieno - teknike dhe të mbrojtjes në punë;
- Merr masa preventive të mos vijë deri te dëmtimi i aseteve të KRU "Hidromorava";
- Përpilon planin e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë si dhe zgjerimin, rikonstruimin e objekteve të Kompanisë, në mënyrë që të sigurohet funksionaliteti dhe efikasiteti i plotë i tyre;
- Vetë dhe me kuadër tjetër plotësues, përgatit projekte ideore hidro - ekonomike për Kompaninë dhe për palë te treta;
- Gjatë fazës së projektimit dhe ndërtimit bënë mbikëqyrjen e plotë të punëve dhe kohë pas kohe përgatitë informata, raporte, mendime profesionale për Kompaninë kurse çdo gjashtë muaj paraqet raportin periodik mbi problemet e punës dhe rezultatet e arritura;
- Kujdeset për mbrojtjen e ujit si lëndë e parë, prej burimit e gjerë në liqen dhe në bazë të analizave laboratorike përcakton shkaktarin e ndotjes së ujit dhe organizon punën dhe masat e duhura për ta sanuar atë;
- Përcjellë kualitetin e ujit prej burimit të ujit, deri te shpenzuesi;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit te tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm si vijon:

- Aplikacionin e punësimit të plotësuar (e gjeni në uebfaqe të kompanisë);
- Dëshmi të kualifikimit shkollor (origjinal ose të noterizuar);
- Dokumentin e identifikimit (kopje të letërnjoftimit, pasaportës);
- Cv (Jetëpëshkrimi);
- Dëshminë e përvojës së punës (përmes Trustit pensional);
- Çertifikatën se aplikuesi nuk është nën hetime dhe nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale (vërtetimi lëshohet nga Gjykata);
- *Kualifikime të tjera profesionale(nëse ka);*

Çertifikatën mjekësore(për shkak të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve pjesëmarrës në konkurs, në fund të procedurës rekrutuese, e njejta do të kërkohet vetëm nga kandidati i suksesshëm, para se të bëhet nënshkrimi i kontratës së punës).

Aplikimi bëhet online përmes e-mailit zyrtar: puna@kru-hidromorava.com, ku bashkangjiten dokumentet e kërkuara sipas konkursit.
Konkursi publikohet përmes uebfaqes zyrtare të kompanisë KRU. "Hidromorava" - SH.A., Gjilan, **https:// kru-hidromorava.com/konkurse**, ku mund të shkarkohet *aplikacioni për punësim.*

Konkursi do të jetë i hapur për aplikim 15 ditë, nga data **09.06.2025 deri më 23.06.2025**.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse aplikacionet e pakompletuara dhe joadekuate do të refuzohen.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:
Intervista - deri në 70 (shtatëdhjetë) pikë;
Jetëpërshkrimi (CV) - deri në 30 (tridhjetë) pikë.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:
Intervista me gojë brenda 20 ditëve pas mbylljes së konkursit;
Rezultatet përfundimtare brenda 10 ditëve pas përfundimit të procesit të intervistave.

Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit ftohen për intervistën me gojë, si dhe njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës me gojë.

KRU. " Hidromorava" - SH.A.